





Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Të mësojmë dhe të mbrojmë të drejtat përmes lojës dhe aktiviteteve



QENDRA PËR ADMINISTRIM
SOCIAL EKONOMIK
TERRITORIAL



ANI

Pjesëmarrja në Kompasito ishte shumë e bukur pasi ne nuk na duhej vetëm të dëgjonim por të jepnim dhe mendimet tona.

Lojrat që zhvilluam i mbaj mend. Më pelqeu shumë aktiviteti ku ne votuam për të zgjedhur pikturat.

Ishte hera e pare që unë votoja . Votova shoqen që më përfaqësonte më shumë .

Votat u numeruan të gjitha. Vota ime ishte e rëndësishme për shoqen time pasi ajo u zgjodh por edhe për mua pasi mendimi im do të përfaqësohej nëpërmjet shoqes time.



Erga



Më pelqeu shumë idea që ne do të krijojmë këtë "news letter".

Unë kisha shumë ide të cilat i diskutuam në grup dhe vendosëm bashkë me shoqet dhe shokët.

Ishte e vështirë pasi donim të zgjidhnim punimet më të bukura dhe ato që transmetonin më shumë mesazhe të të drejtave të fëmijëve.

Të drejtat e fëmijëve janë shumë të rëndësishme dhe të gjithë fëmijet duhet ti njohin dhe ti mësojnë ato.

Irena

Lojrat e Kompasitos me pelqyen. Mbaj mend shumë lojra që ne zhvilluam për të drejtat e fëmijëve. Madje ne edhe pikturoam dhe bëmë punimet tona me tema të ndryshme.

Lojrat më të bukura që mua më pelqyen më shumë i kam treguar edhe tek shoqet në klasë. Ato nuk kishin bërë lojra kompasito për të drejtat e fëmijëve. Lojrat që une u tregova u pelqyen shumë.



Klara

Unë u votova nga shokët për të qenë në jurinë e cila përzgjedhi punimet më të mira të fëmijëve. Shokët më zgjedhën mua pasi unë i përfaqësoja më mirë ata.

Të gjithë ata e dinë që unë vizatoj shumë bukur dhe kur të rritem do të bëhem piktores.

Meqënëse unë vizatoj bukur atëherë të gjithë menduan se unë mund të vlerësoja më drejt punimet më të bukura që meritojnë të përzgjidheshin.

U votova nga të gjithë dhe kjo ishte një kënaqësi shumë e



madhe për mua pasi ata më besuan mua.

Unë së bashku me 4 antarë të tjerë formuam juri dhe morrëm vendim për vizatimet që kishin më tepër mesazhe dhe ishin punuar më bukur nga të tjerat.

U ndjeme shumë mire. U ndjeme të vlerësuara dhe të rëndësishme për të marrë vendimin për pikturat me të bukura.

Indrit

Më ka pëlqyer shumë loja "Djemtë nuk qajnë". Skeci që grupi im i shokëve përgatiti ishte më i bukur.

Diskutuam shumë pasi ne nuk ishim dakort që vajzat mund të jenë shefe.



Nuk ishim dakort as që vajzat janë më të zgjuara sesa djemtë.

Në fund të gjithë pranuan se edhe pse djemtë dhe vajzat janë të ndryshëm fizikisht ne kemi të gjithë të drejta të barabarta.

Laura

Kalendari për të drejtat e njeriut ishte loja më e bukur për mua. Unë zgjedha datat që unë i festoj. Ishin shumë data të rëndësishme që ne diskutuam me shokët për të drejtat tona dhe për festat por unë zgjedha me të bukurat për mua dhe planifikova me shoqen time të ngushtë se si do ti festoj këto festa.





www.asetcenter.al
+355 693113606
info@asetcenter.al

Qendra "ASET" promovon mbrojtjen e të drejtave të njeriut, drejtësinë dhe sigurinë sociale, paqen, zhvillimin territorial dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Synon të sigurojë dinjitet dhe barazi, garantimin e të drejtave të personave duke zhvilluar çdo formë të solidaritetit social ndërmjet individëve, duke luftuar çdo formë të varfërisë, duke promovuar iniciativa kulturore, edukative si dhe asistencë ligjore, sociale e shëndetësore.



Ky material është hartuar në kuadër të Projektit:

“Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve”

Zbatuar nga Qendra “ASET”

Metoda Kompasito – metodë ndërvepruese trajnimi për fëmijët dhe profesionistët e Qendrave për Fëmijët në Situatë Rruge.

Kjo ndërhyrje është pjesë e skemës së granteve të projektit “Përfshirja e Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Terre des hommes në Shqipëri. ” Përmbajtja e këtij materiali jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe Terre des Hommes në Shqipëri.